



Qeveria e Kosovës / Republika e Kosovës - Government of Kosovo
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralne Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 1337/2
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 1
Data/Datum/Date: 15.06.2020
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministririt / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 15.06.2020

Ref. KM - 99/20

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), nenin 53, nenin 57 paragrafi 1, nenin 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare Nr.20/21, Qershor 2016), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 2 të Rregullores (QRK)-Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (08.06.2020), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me Ref.KM 66/20, i datës 16.03.2020, që ndërlidhet me shtyrjen e afateve procedurale për zbatimin e projekteve të zhvillimit rural të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.16/2019 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2019.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi më datë 22 qershor 2020.



Vendimi t'i dërgohet:

- Kabinetit të Ministririt;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë; dhe
- Arkivit.